



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 07.09.2010, në orën 13:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Nerxhivane Dauti, Danush Ademi, Ibrahim Makolli, Hajredin Hyseni, Drita Maliqi, Luljeta Shehu, Ibrahim Selmanaj dhe Shpresa Murati.

Pjesëmarrës të tjerë:

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinators dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20. 07. 2010,
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për tatimin në pronën e palujtëshme të Komisionit Funksional nga aspekti i të drejtave të njeriut,
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit nga aspekti i të drejtave të njeriut,
5. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për qasje në dokumentet publike nr. 03/L'215 nga aspekti i të drejtave të njeriut,
6. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 03/3671/L-214 të 19.5. 2010 për vlerësimin e ndikimit në mjedis nga aspekti i të drejtave të njeriut,
7. Shqyrtimi i disa peticioneve,

8. Të ndryshme.

Kryetari- I përshëndeti të pranishmit dhe u dëshiroi mirëseardhje pas pushimit veror. Ai tha se Komisionin e pret një punë shumë e vëllimshme, dinamike pasi që ky Komision është bërë i përhershëm.

Pra, kërkohet të gjithë së bashku të angazhohemi që çështja e lirive dhe të drejtave të njeriut të trajtohet në dimensionet që i duhen kësaj shoqërie.

Ai në vija të trasha foli për projektplanin e punës që është paraparë për muajt në vijim, të fillohet të zbatuarit dhe duhet t'i përmbahemi sa të mundemi, qoftë në shqyrtimin e projektligjeve të cilat kërkojnë një mendim nga Komisioni lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, qoftë si parime të përgjithshme me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Gjithashtu do të organizojmë ndonjë vizitë pune nëpër institucione të caktuara, ndonjë tryezë me grupet e interesit, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në fusha të caktuara. Ai kërkoi ta forcojmë bashkëpunimin me zyrat ndërkombëtare që janë në Kosovë, si OSBE- në UNDP- inë, zyrat e tjera që janë me interes të veçantë në fushën që e mbulon ky komision. Pastaj u vazhdua me shqyrtimin e agjendës.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20. 7. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.07.2010.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për tatimin në pronën e palujtëshme të Komisionit Funksional nga aspekti i të drejtave të njeriut

Komisioni konstatoi se amendamentet e Projektligjit për tatimin në pronën e palujtëshme të Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa, janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme, standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund t'i procedohen Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit nga aspekti i të drejtave të njeriut

Komisioni konstatoi se amendamentet e Projektligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit të Komisioni Funksional, për Buxhet dhe Financa janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut,

Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

5 Shqyrtimi i amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për qasje në dokumentet publike nr. 03/L'215 nga aspekti i të drejtave të njeriut

Ibrahim Makolli- Tha se ka vërejtje në amendamentin 19, edhe pse ndoshta nuk e prek fushën e të drejtave të njeriut, por ky komision i obligon institucionet publike që në formë elektronike dhe përmes botimit në Gazetën Zyrtare t'i publikojnë të gjitha dokumentet e publikushme, të cilat ata i hartojnë. Kjo bie ndesh me ligjin për Gazetën Zyrtare. Ligji për Gazetën Zyrtare përcakton se çka publikohet në të.

Ai gjithashtu kishte vërejtje te amandamenti 24, neni 19.4, ku thuhet: Institucionet publike të Republikës së Kosovës obligohen që Qeverisë t'i raportojnë rregullisht, përkitazi me zbatimin e këtij ligji, jo të gjitha agjencitë i raportojnë Qeverisë për zbatimin e këtij ligji. Prandaj ka autoritete në vend që nuk i përgjigjen Qeverisë për zbatimin e këtij ligji, por i përgjigjen drejtpërdrejt Kuvendit ose autoriteteve të tjera.

Prandaj sipas kësaj, amendamenti 19 e thotë: Obligon çdo material që publikohet në Gazetën Zyrtare. Ai pati vërejtje ngase është në kundërshtim me dispozitat e ligjit për Gazetën Zyrtare, ndërsa amendamenti 24 i obligon institucionet publike që t'i raportojnë Qeverisë për zbatimin e këtij ligji, që është në kundërshtim me ligjet e tjera në fuqi.

Komisioni u pajtua me diskutimin e parafolësit dhe vendosi që ta informojë Komisionin FunkSIONAL lidhur me këto vërejtje, *t'i korrigjojë, me arsyetimin se janë në kundërshtim me ligjin për Gazetën Zyrtare dhe ligjet e tjera që rregullojnë këto fusha.*

Komisioni konstatoi se amendamentet e Projektligjit për qasje në dokumentet publike nr. 03/L-215 të Komisioni FunkSIONAL, për Administratë Publike, Pushtetin Lokal dhe Media janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

6 Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 03/3671/L-214 të 19.5. 2010 për vlerësimin e ndikimit të mjedisit nga aspekti i të drejtave të njeriut

Komisioni konstatoi se amendamentet e Projektligjit nr.03/3671/L-214 i 19.5.2010 për vlerësimin e ndikimit në mjedis të Komisioni FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Haspsinor janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

7 Shqyrtimi i disa peticioneve

Nerxhivane Dauti - Në cilësi të raportueses tha se i ka shqyrtuar tri peticione të ushtruara nga znj. M. Q. avokate nga Prizreni, Sh. B. nga Peja dhe B. Q. nga Vushtrria, për të cilat kishte ofruar zgjidhjet.

Komisioni lidhur me këto peticioni nxori rekomandime përkatëse.

Ibrahim Makolli - Duke u ndërlidhur me peticionet tha se ka shumë lëndë që nuk ekzekutohen, prandaj do të ishte mirë që Komisioni të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit që të lejohet një debat për mosekzekutimin e vendimeve nga ana e autoriteteve publike.

Nerxhivane Dauti - U pajtua me mendimin e parafolësit dhe i njoftoi se zyra e USAID - it është duke e trajtuar këtë çështje dhe mund të kërkohej një informatë zyrtare se çka është duke bërë kjo zyre.

Fatmir Rexhepi - Duke u ndërlidhur me parafolësit për moszbatimin e aktgjyqimeve të plotfuqishme të gjykatave komunale tha se si Komision po përgatitemi dhe pasi t'i kemi të gjitha informatat e sakta, brenda një periudhe dymujore do të organizojmë dëgjimin publik.

8 Te ndryshme.

Ibrahim Makolli - Ngriti dy çështje që paraqesin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe tha se këto të drejta janë të garantuara me kushtetutë dhe me norma ndërkombëtare. E para ka të bëjë me nxjerrjen e vërtetimeve për ta vërtetuar se a është nën hetime ose jo, e që u nevojiten palëve për nxjerrjen e dokumenteve të udhëtimit.

Ai e cilësoi veprimin organeve si të padrejtë, sepse në drejtësi ekziston presupozimi i pafajësisë, Njeriu mundet me qenë nën hetime dhe të mos e dijë se është nën hetime për 10 vjet ose nuk i ka ardhur radha lëndës për shqyrtim.

Prandaj me kushtëzimin e nxjerrjes së dokumenteve të udhëtimit, me nxjerrjen e këtij vërtetimi është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Pra, për t'u pajisur me dokumente të udhëtimit është e garantuar me kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare.

Çështja tjetër është kushtëzimi për regjistrimin e automjeteve me pagesën e tatimit në pronë.

Pra, ai theksoi se është e kundërligjshme, ngase nuk ka ligj që e precizon për ta regjistruar automjetin, duhet të paguhet më parë tatimi në pronë. Komisionit i kërkon të kërkojë nga Ministria e Punëve të Brendshme sqarim lidhur me regjistrimet dhe se veprimi a është i rregulluar me ligj?

Hajredin Hyseni – U pajtua me parafolësin dhe tha se për t'i kontribuar zgjidhjes së këtij problemi do ishte mirë që si Komision fillimisht të kërkohej nga Ministria e Punëve të Brendshme një informatë me shkrim dhe të paraqiten këto dy çështje.

Fatmir Rexhepi - Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se janë dy çështje që i prekin të drejtat e njeriut përmes kushtëzimit. Ne mund të adresojmë një kërkesë se kemi shqyrtuar këto dy fenomene dhe kërkojmë një informatë nga këto dy ministri se a janë duke vazhduar këto apo mos ka ndryshuar diçka në këtë drejtim?

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi